



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

**KD.nr.01/2018**

**KOMISIONI DISIPLINOR**, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinor kundër Xxxxxx xxxxxxx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx-xxxx xx xxxxxxx sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-260, në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/13/2017, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, Xxxxxx Xxxxxxi, dhe gjyqtarit Xxxxxx Xxxxxx, më datën 31.01.2018, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

**V E N D I M**

1. Xxxxx Xxxxxxx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx-Dega në Xxxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2017-260, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/13/2017, të përcaktuar në nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtarit Xxxxx Xxxxxxx i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 50% në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

**A r s y e t i m**

Zyra e Prokurorit Disiplinor i'a ka paraqitur raportin përfundimtar me numër ZPD-2017-260 se bashku me shkresat e lëndës Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më të cilin gjyqtarin XxxxxXxxxxxxx e ka akuzuar për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i

funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223).

Hetimin disiplinor Zyra e Prokurorit Disiplinor ndaj gjyqtarit Xxxxxx e ka filluar sipas detyrës zyrtare bazuar në informacionet e pranuar nga një zyrtar i gjykatës me datë 13 prill 2017. Pretendimet kanë qenë se gjyqtari Xxxxxx përkundër faktit që ka pranuar pagë mujore të gjyqtarit, i njëjti nuk e ka ushtruar këtë funksion gjyqësor, duke mos u paraqitur në punë. Ka siguruar prova të pakontestueshme në mbështetje të këtij raporti përfundimtar andaj bazuar në nenin 34 paragraf 1 të Ligjit për KGJK-ën, ZPD i rekomandoj Komisionit Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore sepse gjyqtari nuk ka arritur të përfaqësojë Gjykatën duke mos e ushtruar funksionin gjyqësor që nga viti 2008 kur edhe është dekretuar për gjyqtar. I njëjti ka dështuar në kryerjen e funksionit gjyqësor dhe ka bërë shkelje të kodit të etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtar.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 31.01.2018, Gjyqtari Xxxxxx ka deklaruar se si gjyqtar ishte emëruar prej vitit 2004 deri në 2008 në UNMIK. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës për shkak të situatës politike gjithë çka kishte ndryshuar. Situata politike në këtë kohë ka qenë shume e vështirë në Xxxxxxx. Atëherë ka qenë Gjykatë Komunale në Xxxxxxx, dhe se me nxjerrjen e Ligjit për Gjykatën u shua si Gjykatë Komunale dhe u emërua si degë e Gjykatës së Xxxxxxxs. As ai si gjyqtar dhe as të punësuarit tjerë të administratës nuk kishin pranuar ndonjë vendim që ata duhet të shkonin në Gjykatën e Xxxxxx apo Xxxxxxx. Të gjithë stafit administrativ ju kishin vazhduar kontratat e punës nga KGJK. Ndërsa sa i përket gjyqtarëve askush nuk i kishte njoftuar asgjë, dhe nuk ishte i njoftuar se pse kjo degë në Leposaviq nuk ka punuar, por e njëjta ka punuar në Xxxxxxx.

I pyetur nga Komisioni Disiplinor se kur i ishte lëshuar vendimi i fundit me të cilin ishte emëruar si gjyqtar në degën e Xxxxxx, gjyqtari Xxxxxx është përgjigjur se për herë të fundit si gjyqtar ishte emëruar në 2013, në kohën kur ka qenë Xxxxxxxx kryesues i KGJK-së. Kishte kërkuar nga Xxxxx xxxxxx u.d i kryetarit të Gjykatës Themelore në xxxxxxx që të sigurohen të gjithë të punësuarit dhe të punojnë në Xxxxxxxx dhe është pyetur se pse duhet të vij për çdo ditë nga Xxxxxx në Xxxxxx. Përgjigja sipas u.d i kryetarit Xxxx Xxxxxx kishte qenë se edhe ai po pret që të gjithë të kthehen në Xxxxxx, e për këtë po e presin përgjigje nga ambasadori iXxxxxxx.

Gjyqtari XXxxxxx me tutje ka theksuar se në Xxxxxxxx ka shkuar në punë për çdo ditë, mirëpo nuk kishte zgjedhur asnjë lëndë sepse nuk ja kanë ndarë lëndë. Sipas gjyqtarit Xxxxxx ai vazhdimisht kishte kërkuar që të punoj në xxxxxxx por asnjëherë nuk ju kishte kthyer përgjigja. Në janar të vitit 2016 gjyqtari xxxxxx ishte ftuar nga Xxxxx Xxxxxx u.d i kryetarit të Gjykatës së Xxxxxx, që kanë qenë të vendosur në objektin e gjykatës në Vushtrri, që të fillojë punën duke kërkuar që të marrin disa lëndë ai dhe gjyqtarja Xxxxx XXxxxxx. Një muaj ka filluar të shkojë, mirëpo ju kishte prishur vetura edhe për kundër kërkesës për zëvendësim me një veturë tjetër kjo nuk kishte ndodhur.

Aktualisht gjyqtari Xxxxxxx është gjyqtar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Xxxxxx në xxxxxxxx i janë ndarë rreth 100 lëndë, dhe po përgatiten për të filluar me caktimin e seancave.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se gjyqtari është i obliguar që të kujdeset në zbatimin e detyrimeve ligjore, të parapara në nenin 34 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.4 të Ligjit për KGJK-ën. Ka për obligim ta mbroj imazhin e sistemit gjyqësor, dhe të tregoj seriozitet dhe dinjitet të cilën qytetaret kanë të drejtë ta presin nga sistemi i drejtësisë. Gjyqtari Xxxxxxx në rastin konkret me mosardhjen e tij në vendin e punës, prej vitit 2008 përkundër faktit që ka marrë pagë mujore i njëjti nuk ka ushtruar funksionin gjyqësor, sipas ZPD është sjellje e papranueshme dhe me vete dije ka dëmtuar reputacionin e gjykatës dhe buxhetin e Kosovës. ZPD e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar dhe ka konsideruar se faktet e prezantuara në këtë raport janë të pakontestueshme. I ka rekomanduar Komisionit Disiplinor ta shpall përgjegjës gjyqtarin Xxxxxxx Xxxxxxx, për sjellje të pahijshme dhe ti shqiptoj masë disiplinore në përputhje me rrethanat dhe nivelin e përgjegjësisë.

Gjyqtari xxxxxx në fund deklaroj se për shkak të ligjit ekzistues të atëhershëm të vitit 2013, Lepasaviqit është praktikisht degë e Gjykatës Themelore në xxxxxxxx. Në këtë objekt i kemi të gjitha kushtet edhe për gjyqtarë edhe për personelin ndihmës. Me këtë situatë jam vënë si fajtor i vetëm në Xxxxxxx, çka po ndodh me ata rreth 20 punonjës që asnjë ditë nuk kanë qenë në Xxxxxxxx. Për çdo vite kontrata e tyre janë vazhduar dhe kanë qenë në listë të pagave. Ne kemi shkuar kur na kanë thirr, unë, daktilografët, përkthyesi dhe shoferët. Xxxx xxxxxx si u.d. i kryetarit të Gjykatës se xxxxxx, në janar të vitit 2016 nuk i ka ftuar në punë personelin tjetër dhe se nuk e dinë arsyen se pse. Ka deklaruar se në atë kohë ka qenë gjyqtarë mbikëqyrës, dhe ka mundur t'ju them punëtorëve që të vinë në Lepasaviq, sipas ligjit kemi pasur të drejtë të punojmë atje, jemi degë e Gjykatës së xxxxxxx, por jo në xxxxx. Theksoj se e gjithë kjo është storie politike. Nëse flitet vetëm për përgjegjësinë time, atëherë KGJK duhet të marrë përgjegjësinë për të gjithë të punësuarit në komunat Lepasaviq dhe Zubin Potok, që u janë vazhduar kontrata dhe i kanë marrë pagat.

Komisioni Disiplinor, në procedurën e provave i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, parashtrësat e dorëzuara nga ZPD-ja të cilat nuk kanë qenë të bashkangjitura në raportin përfundimtar. Pasi i shqyrtoj dhe analizoj të gjitha provat, analizoj edhe deklaratën e gjyqtarit xxxxx xxxxxx konstatoj se ekziston përgjegjësi e rëndë disiplinore e gjyqtarit xxxxxx. Sipas vlerësimit të Komisionit qëndron pretendimi i ZPD-së se z.xxxxxx ka bërë shkelje disiplinore me të cilat është ngarkuar, dhe se rrethanat e shumta lehtësuese të cilat i ka cekur dhe ekzistenca e të cilëve është e sigurt, nuk janë të ndërlydhura nga ekzistenca e shkeljes disiplinore.

Në seancën për këshillim dhe votim Komisioni njëzëri vendosi së Xcxxxxx Xxxxxxx është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, apo keqpërdorim i funksioneve gjyqësore, dhe 1.4-shkelje e kodeve të zbatueshme të etikës. Lidhur me këtë, Komisioni në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 50% në**

**kohëzgjatje prej gjashtë ( 6 ) muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Me rastin e e shqiptimit të masës disiplinore, Komisioni, si rrethanë lehtësuese, mori parasysh edhe situatën jashtëzakonisht komplekse në atë pjesë të Kosovës, e cila është dëshmi e mjaftueshme dhe fakt që statusi i institucioneve gjyqësore nuk mund të zgjidhej dhe madje as krijimi i të njëjtëve nuk ishte i mundur pa marrëveshje ndërkombëtare, në krijimin e të cilave ishte pjesëmarrëse aktive bashkësia ndërkombëtare, ku zbatimi i të cilave do të ishte i pamundur pa të. Në këtë situatë në terren, është vërtet joreale të presësh një individ, një gjyqtar, të punojë, të planifikojë gjykimet dhe të bëjë gjykime në periudhën para zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit.Thjesht diçka e tillë nuk ishte e mundur. Nga ana tjetër, është një pikëpyetje e madhe e çështjes dhe mundësia që ata gjyqtarë të angazhoheshin në gjykata të tjera, pasi që që këta gjykatës dhe familjet e tyre janë të ekspozuar ndaj vështirësive, kërcënimeve dhe dënimit të mjedisit nuk duhet të shqetësohen. Vetëm arsyet e cekura më lartpërmendura kanë vendosur që masa më e rëndë disiplinore e shqiptuar, jo nga ky komision, t'i shqiptohen gjyqtarit xxxxxxxx, sepse ne rastin konkret flitet për shkelje e rëndë disiplinore, ekzistenca e së cilës është e pakontestueshme.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR**  
**KD.nr.01/2018, date 31.01.2018**

Kryetar i Komisionit Disiplinor  
Nenad Lazic

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimet të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Arianit Salihu, u.d drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx Xxxxxx, kryetar në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx;
- Xxxxx Xxxxxxxx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxxx-dega në Xxxxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;